

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “JSL CONSTRUCTION” SHPK

Sot me datë 01.03.2023, ne, të poshtëshënuarit:

- Znj. Lusinda Çullhaj shtetase Shqiptare, e datëlindjes 26.01.2003, e bija e Flamur, lindur dhe banuese në Tiranë, me nr. Letërnjoftimi 036414385 dhe ID. K35126041I, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,
- Z. Sotiraq Spiri, shtetas shqiptar, i datëlindjes 13.05.1971, i biri i Theofan, lindur në Fier e banues në Tiranë, me nr. Letërnjoftimi 037078712 dhe ID. H10513018V, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,
- Znj. Joana Roçi, shtetase shqiptare, e datëlindjes 24.11.2004, e bija e Bujar, lindur e banuese në Tiranë, me nr. Letërnjoftimi 037864379 dhe ID. K46124042J, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “i ndryshuar” “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, kemi vendosur të themelojmë Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar “JSL CONSTRUCTION” SH.P.K (më poshtë referuar si “Shoqëria”) duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akt Themelimi dhe i bashkangjitet.

Neni 1

Emërtimi dhe Selia Juridike e Shoqërisë

1. Emri i Shoqërisë është “JSL Construction” Sh.p.k.
2. Shoqëria tregtare “JSL Construction” Sh.p.k ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në adresën: Komuna Katund i Ri, Durrës, Godine Private Sektori Rinia, Objekti: Summer X.
3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 2

Kohëzgjatja

1. Shoqëria tregtare “JSL Construction” Sh.p.k., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së vet me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti Juridik të ri.

Neni 3

Objekti

Shoqëria tregtare “JSL Construction” SH.P.K., ka si objekt veprimtarie:

1. Projektim dhe Ndërtim i objekteve civile – industriale – turistike – hoteleri – bujqësore si dhe rikonstruksione.
2. Prodhime betoni, parafabrikate dhe konstruksion për ndërtim pallatesh, objekte industriale, ujësjellësa e kanale, ndërtim rrugësh, veprash hidroenergjitike, hece, hidrocentrale, objekte social kulturore dhe shërbimi e banimi, etj.
3. Tregtimit me shumicë dhe pakicë dhe import-eksport të: mallrave të ndryshëm ushqimor, industrial, pije konfeksione, fruta-perime, materiale ndërtimi e nënprodukteve të tyre, elektro-shtëpiake, mobilje, pajisje elektrike dhe elektronike, hidrosanitare, hidraulike, kinkalери, kancelari zyre e shkolle, pjesë këmbimi për auto, bateri, goma.
4. Ndërtimit, zbatimit, punime dheu, sistemime, tracime terrenesh, ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtime vepra arti, punime mbrojtje dhe sistemimi hidraulike.
5. Rikonstruksione godinash civile ekonomike, kryerjen e situacioneve, preventivave dhe zbatim të objekteve të ndryshme ndërtimi.
6. Marrja përsipër dhe kryerja e çdo aktiviteti të ngjashëm me objektin dhe veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 4

Kapitali

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njëqind mijë) lekë.**



2. Kapitali është i përbërë nga 3 (tre) kuota me vlerë 100.000 lekë që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.
3. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:
Znj. Lusinda Çullhaj është zotëruese e 1 kuote me vlerë 33000 lekë që përbën 33% të kapitalit të shoqërisë;
Z. Sotiraq Spiri është zotërues i 1 kuote me vlerë 33000 lekë që përbën 33% të kapitalit të shoqërisë;
Znj. Joana Roçi është zotëruese e 1 kuote me vlerë 34000 lekë që përbën 34% të kapitalit të shoqërisë;

Neni 5

Transferimi i kuotave të kapitalit

Kuotat e kapitalit mund të transferohen lirisht të tretëve, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara nga Statuti i Shoqërisë.

Neni 6

Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga administratori. Ortakët emërojnë një ose më shumë persona fizikë si Administratorë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.
2. Nëpërmjet këtij akti, në Shoqërinë “JSL Construction” Sh.P.K. emërohet administrator Z. Klaidi Roçi për një afat pesë vjeçar.
3. Administratori ka të drejtë të veprojë, personalisht ose duke i deleguar personave të tretë, lidhur me të gjitha procedurat për regjistrimin e Shoqërisë si person juridik pranë organit kompetent. Ai është i autorizuar të veprojë për llogari të Shoqërisë deri sa regjistrimi i saj të ketë përfunduar.
4. Administratorit të sipërpërmendur i jepen të gjitha të drejtat e administrimit, të zakonshëm e të jashtëzakonshëm, duke përfshirë edhe nënshkrimin dhe ekzekutimin e të gjitha akteve në emër dhe për llogari të Shoqërisë dhe ai mund të delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

“JSL Construction” Sh.P.K.

LUSINDA ÇULLAHJ

SOTIRAQ SPIRI

JOANA ROÇI

